

MENAXHIMI FINANCIAR PËR MENAXHERËT JO-FINANCIERË

Përshkrimi i kursit

Menaxhimi financiar është jetik për menaxhimin e përgjithshëm të shoqërive ujësjellës kanalizime. Vendimet të cilat merren pa kuptuar mirë pasojat financiare mund të çënojnë performancën e shoqërisë. Ky kurs trajnimi ka si qëllim ndërgjegjësimin e pjesëmarrësve për rolin e menaxhimit financiar.

Kursi do të trajtojë çështje të cilat kanë të bëjnë me ciklin, rolet dhe mjetet e menaxhimit financiar, kontabilitetin, kostot e shërbimit, vendosjen e tarifave si dhe planifikimin e kapitalit.

Pjesëmarrësit do të pajisen me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të përdorur informacionin financiar për të marrë vendime më të mira afatshkurtëra dhe afatgjata.



Kush duhet të marrë pjesë

Ky kurs është hartuar për profesionistët e shoqërive ujësjellës kanalizime dhe është veçanërisht i vlefshëm për menaxherët, drejtorët e drejtorive si dhe për çdo punojës të interesuar për të marrë njohuri thelbësore financiare.

Objektivat e kursit të trajnimit

Në fund të këtij kursi trajnimi, ju do të jeni të aftë të:

- Kuptoni rolin e menaxherit financiar dhe individëve të tjerë në shoqëri të përfshirë në menaxhimin financiar;

- Përdorni raportet financiare për të analizuar performancën e shoqërisë;
- Identifikoni instrumentet e menaxhimit financiar që mund të përdoren në një shoqëri;
- Përcaktoni kërkesën e të ardhurave për një shoqëri;
- Identifikoni shpenzimet operacionale dhe ato të mirëmbajtjes;
- Kuptoni parimet e Entit Rregullator të Ujit në përcaktimin e tarifave;
- Analizoni një strukturë tarife;
- Identifikoni shpenzimet kapitale;
- Analizoni faktorët që ndikojnë në planifikimin e kapitalit;
- Analizoni projektet kapitale;
- Përcaktoni përfitimet financiare dhe jo-financiare të çdo projekti;
- Analizoni kostot dhe përfitimet e çdo projekti.

Metoda e trajnimit

Trajnimi është i bazuar në leksione të prezantuara në PowerPoint, të ndërthurura me diskutime dhe raste studimore. Përveç marrjes së leksioneve dhe diskutimeve, pjesëmarrësit do të analizojnë edhe raste konkrete studimore.

Materialet e kursit të trajnimit

Pjesëmarrësit në këtë kurs trajnimi, do të pajisen me Manualin e Trajnimit "Menaxhimi Financiar për Menaxherët Jo-Financierë". Përpos kësaj, pjesëmarrësit do të pajisen me certifikatë.

Tarifa e regjistrimit

Anëtarët e SHUKALB/SHUKOS: 22,000 lekë për person

Jo-anëtarët: 25,000 lekë për person.

Kjo tarifë përfshin materialet e kursit, drekat, dhe pushimet për kafe.